

AVOKAT -LAWYER
TOMË (VIKTOR) GASHI

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS
PËR DEPARTAMENTIN E INSPEKTIMIT NË PRISHTINË

NGA: Avokat Tomë Gashi, përfaqësues juridik i Kompanisë "Media Marketing SH.A, me seli në Qendren Tregtare Gorenje, Veternik – Prishtinë, të përfaqësuar nga Drejtori z. Rexhai Shabani.

KËRKESË PËR ANULLIMIN E VENDIMIT MBI ELIMINIMIN E PARREGULLËSIVE TË INSPEKTORATIT TË INFRASTRUKTURËS RRUGORE ME NR PROTROLLI 11025/MT/2020, DATË 08.12.2020

Në cilësinë e përfaqësuesit juridik të Media Marketing kemi paraqitur ankesë kundër vendimit mbi eliminimin e parregullësive të inspektorit të inspektimit për infrastrukturë rrugore me nr të protokollit 11025/MT/2020, datë 08.12.2020, në cilësinë e përfaqësuesit juridik "Media Marketing" SH.A.

Gjykata Themelore në Prishtinë ka aprovuar kërkesen tonë si të bazuar dhe ka urdhëruar shtyerjen e ekzekutimit të vendimit, deirsa Gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor perkitazi me padinë e paditësit.

Bashkëlidhur ju dërgojmë Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për çështje administrative me nr A.nr.21/2021 të datës 26.01.2021.

Andaj kërkojmë nga Ju që të respektoni vendimin gjyqësor .

Me respekt,
Tomë Gashi
Prishtinë
08.02.2021

Shtesë : Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë nr A.nr.21.2021

REPUBLIKA E KOSOVËS/RIPIBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT	
MINISTRIJA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT	
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION	
Njësi Org./Shlyerja Org./Ura	Nr. i Prot. Broj Prot.
04	1014
Nr. i Faqeve Br./Stranica No. Pages	Data: Datum: Date:
1+SH	08.02.2021
PRISHTINË/A	



29/01/21

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.21/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit, Kompania Media Marketing, Sh.A, me seli në Qendren Tregtare Gorenje, Veternik, Prishtinë, të cilën e përfaqëson Drejtori Rexhai Shabani e të cilët me autorizim i përfaqëson Tomë Gashi, avokat nga Prishtina kundër të paditurës Ministria e Infrastrukturës me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit nr. 01.prot.9646 të datës 07.12.2020 me propozim për shtyerjen e ekzekutimit të të njëjtit, jashtë seancës me datë 26.01.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

I: APROVOHET si i bazuar propozimi i paditësit/propozuesit Kompania Media Marketing, Sh.A, me seli në Qendren Tregtare Gorenje, Veternik, Prishtinë, të cilën e përfaqëson Drejtori Rexhai Shabani e të cilët me autorizim i përfaqëson Tomë Gashi, avokat nga Prishtina.

II. SHTYHET ekzekutimi i Vendimit nr. 01.prot.9646 të datës 07.12.2020 i të paditurës Ministria e Infrastrukturës me seli në Prishtinë, derisa Gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit.

A r s y e t i m

Paditësi/propozuesi Kompania Media Marketing, Sh.A, me seli në Qendren Tregtare Gorenje, Veternik, Prishtinë, të cilën e përfaqëson Drejtori Rexhai Shabani e të cilët me autorizim i përfaqëson Tomë Gashi, avokat nga Prishtina, ka ushtruar padi në këtë Gjykatë me datë 06.01.2021 kundër të paditurës Ministria e Infrastrukturës me seli në Prishtinë me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 01.prot.9646 të datës 07.12.2020, me propozim për shtyerje të ekzekutimit të të njëjtit.

Gjykata, me qëllim të vlerësimit të këtij propozimi, ju referua nenit 22, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: *"Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar"*.

Gjykata poashtu ju referua nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: *"Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyerjen e ekzekutimit të aktit administrativ, deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni"*.

Bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, duke shqyrtuar kërkesën për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, Gjykata vlerësoi se paditësi/propozuesi ka ofruar argumente të besueshme të cilat vërtetojnë faktin se ekzekutimi i vendimit do t'i sillte dëm i cili vështirë do të riparohej. Në këtë drejtim, gjykata mori në konsideratë obligimet kontraktuale të bashkëngjitura në padi, mos-përmbushja e të cilave në rast të ekzekutimit të vendimit kontestues, do t'i sillte dëm i cili vështirë do të riparohej.

Gjithashtu Gjykata gjeti se shtyerja e ekzekutimit të vendimit deri në vendosjen e çështjes në mënyrë meritore, nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyerja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personave të interesuar. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se nga shkresat e lëndës, aktiviteti i ushtruar nga paditësi, nuk do të mund të ndikoj në dëm të interesit publik, sikurse që shtyerja e ekzekutimit të këtij vendimi, nuk do t'i sillte asnjë dëm të madh personave të interesuar.

Gjykata gjeti se shtyerja e ekzekutimit të këtij vendimi është e arsyetuar në këtë fazë të procedurës së këtij konflikti administrativ dhe kjo do të shmange pasojat e mundshme që do të shkaktoheshin në të ardhmen, nëse vendimi i kundërshtuar i të paditurës, në fund të procesit gjyqësor, rezulton se është marrë në kundërshtim me ligjin.

Këtë vlerësim gjykata e mbështet në faktin se paditësi ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm se bazuar në dispozitat e cekura më lartë, janë përmbushur kushtet ligjore që të aprovohet propozimi për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit derisa Gjykata të vendos përfundimisht lidhur me ligjshmërinë e vendimit të kontestuar përkitazi me padinë e paditësit e në kuptim të nenit 22 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA).

Në këtë kuptim, Gjykata vlerësoi se janë plotësuar kushtet nga neni 22 paragrafi 6 lidhur me paragrafim 2 të LKA-së, për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar, deri në vendosjen përfundimtare të çështjes.

Ky Aktvendim nuk paragjykon epilogun përfundimtar të këtij konflikti administrativ.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e konform nenit 22, paragrafit 7 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.21/2021, datë 26.01.2021



Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate.